

# Komisioneri Publik ankimon vendimin për konfirmimin e gjyqtares Etleva Deda

Komisioneri Publik njoftoi se do kërkonte shkarkimin e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme Etleva Deda në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për kriterin e pasurisë.



Gjyqtaret Etleva Deda dhe Miranda Andoni takohen në sallën e KPK-së pas vendimeve.

Disa pasaktësi në deklarimin e gjendjes cash në vite, mosdeklarimi i mbajtjes cash në shtëpi të kredisë së marrë për blerje shtëpie dhe një dhuratë prej 15 mijë eurosh nga prindërit, janë sipas Komisionerit Publik Florian Ballhysa arsye për të kërkuar shkarkimin e gjyqtares Etleva Deda.

Komisioneri Publik njoftoi të martën se kishte ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit vendimin e KPK të 12 qershorit që kishte konfirmuar gjyqtaren e Gjykatës së Posaçme në detyrë.

“Duke marrë për bazë jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjendjen e fakteve dhe provave në rastin konkret dhe të ligjit të zbatueshëm, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë”, thuhet në ankimin e Komisionerit.

Etleva Deda e nisi karrierën në sistemin e drejtësisë në vitin 2004 si gjyqtare e Gjykatës së Krimeve të Rënda. Në vitin 2010, Deda e drejtoi përkohësisht këtë gjykatë si kryetare e komanduar. Me shkriren e Krimeve të Rënda, ajo kaloi te Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Ajo u konfirmua nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pasi trupa e kryesuar nga Genta Tafa (Bungo) me anëtare Valbona Sanxhaktarin dhe Roland Ilia vendosi se ajo arriti nivel të besueshëm në të tre kriteret e rivlerësimit.

Por Komisioneri Publik mendon se vendimi i Komisionit është “i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim” para Kolegjit.

Në ankim Komisioneri parashtron si arsye pasakëtsi në deklaratimet e gjendjes cash në vite, për të cilat KPK ka arsyetuar se ishin të paqëllimshme, ishin sqaruar në deklaratën veting dhe nuk ishin të mjaftueshme për shkarkim.

Ballhysa thotë se KPK i është referuar gabim Kolegjit të Posaçëm të Apelit mbi deklaratimet e gjendjeve cash dhe paraqet një sërë vendimesh, duke lënë të kuptohet se arsyetimi i Komisionit për pasaktësi të paqëllimta ishte i gabuar.

Po ashtu Komisioneri cilëson si problem mosdeklarimin si gjendje cash të 5 milion lekëve të marrë kredi nga Deda. Sipas Ballhysës gjyqtarja kishte detyrimin të deklaronte pas tërheqjes së shumës nga banka se e kishte atë si gjendje cash, në lekë apo në valutë. “Subjekti i rivlerësimit, pas tërheqjeve nga llogaritë bankare, të shumës prej 5.000.000 lekë, të kryer në vitin 2007, nuk rezultoi të ketë deklaruar në asnjë prej DV-ve të mëvonshme 2007-2008, posedimin e tyre *cash* në banesë ose përdorimin e tyre, në lekë apo në euro, duke bërë kështu të pamundur gjurmimin e këtyre të ardhurave gjatë viteve përkatëse”, thuhet në ankim.

Duke u nisur nga një deklaram i gjyqtares se kishte bërë këmbim të këtyre parave në euro dhe kishte përfituar nga kjo për shkak të kursit të këmbimit, Ballhysa pretendon se ka shkelje të etikës.

“Mbetet e pajustificuar dhe e padrejtë në vlerësimin e etikës së subjektit të rivlerësimit, fakti që subjekti i rivlerësimit ka përdorur vlerën e saj për të përfituar nga konvertimi i monedhave për periudhën në fjalë, përfitime të cilat nuk i ka dokumentuar dhe deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike vjetore”, shprehet Ballhysa.

Ai po ashtu pretendon se prinderit e gjyqtares nuk kishin justifikuar me burime të ligjshme një dhurim prej 15 mijë eurosh në vitin 2011. Ballhysa pranon se paratë ishin marrë nga shitja e një apartamenti, por pretendon se KPK nuk kishte hetuar për burimin e krijimit të apartamentit nga prinderit e gjyqtares në vitin 2003.

Gjithashtu ai vë në dukje edhe disa bilance negative në analizat financiare në vitin 2009 në shumën 629 mijë lekë. Në fund Ballhysa kërkon nga Kolegji që të marrë parasysh ankimin dhe të vendosë për shkarkimin e Dedës.



RRETH AUTORIT

[Vladimir Karaj](#)

Vladimir Karaj është redaktor i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri, BIRN Albania.